

UNIVERSITETI I GJAKOVËS “FEHMI AGANI”

Fakulteti Filologjik

Programi: Letërsi shqipe



PUNIM DIPLOME

Novela *Pishtarët e natës* e Martin Camajt

Mentor:

Prof. Ass. Dr. Labinot Berisha

Kandidatja:

Endrita Meka

Gjakovë 2019

Përmbajtja

Abstrakt-----	3
Objekti i punimit-----	4
1. HYRJE-----	5
1.1. Krijimtaria e Camajt-----	6
2. PRANIA E INTERTEKSTUALITETIT-----	9
2.1. Marrëdhënia e personazheve me tokën, fat dhe frikë-----	13
2.2. Universalizimi dhe simbolika e mitit të ujit-----	16
Përfundim-----	18
Literatura-----	21

ABSTRAKT

Krijimtaria e Camajt, qëndroi për një kohë të gjatë e panjohur për lexuesin shqiptar. Pas vitit 1992, ajo zuri vendin që meritonte në letërsinë shqipe. Ka një numër të konsiderueshëm artikujsh, referatesh, studimesh dhe monografish mbi veprën në poezi e në prozë, më pak mbi dramën. Tekstet shkollorë të botuara pas '90, e kanë përfshirë si autor të rëndësishëm në sistemin parauniversitar, pothuajse në çdo klasë. Poezitë e Camajt janë bërë pjesë e antologjisë së letërsisë shqipe. Botimet dhe ribotimet e disa studimeve tregojnë se ai është një shkrimtar për të cilin lexuesit dhe kërkuesit shkencorë, janë të interesuar. Kjo tregon se veprës së Camajt qasjet nuk i mungojnë, por në të njëjtën kohë nuk janë shteruese për specifikën e vetë stilit të tij, kështu besojmë se sa herë lexohet do të ketë gjithmonë diçka për të vjelë prej artit të tij.

Hulumtimin mbi veprën e Camajt e kemi parë në një këndvështrim të ri për të sjellë e zbuluar ato anë të pastuduara plotësisht ose të prekura më parë vetëm përciptazi. Gjuha e pasur dhe larmia dialektore e shprehjeve, frazave shpesh të krijon imazhin e një fjalori voluminoz, që mbart kuptime të shumta; nga ana tjetër Camaj rrok mendime të thella dhe i drejton lexuesit nga kahu i qenësisë historike, arkaike, për të njohur vetveten. E shkuara është kujtesë, pa të njeriu është në kaos. Në veprën e tij, ajo lidhet me një vend, ritual, etnografi, rapsodi, mënyrë të menduari e të besuari, të gjitha vijnë bashkë për të hequr mallin a pluhurin e kujtimeve, për t'i tejkaluar a për të mësuar prej tyre, për të qenë gjithmonë vetvetja, me gjuhë, kulturë, histori dhe vetëm atëherë mund të fillosh t'i rrëfesh, siç vetëm Camaj di.

Martin Camaj, ndërton profilin e tij artistik me bazë tabanin folklorik shqiptar duke përdorur me mjeshtëri të rrallë koloritin përshkrues e përbërës të përrallës. E bardha dhe e zeza; ngjyrat më të hasura në përrallat tona, ndërthuren harmonishëm në personazhet, figurat dhe ngjarjet e krijimtarisë camjane. Orteku i dëborës, zija shpirtërore (Rrunggaja në Mars) si mallkim i pashmangshëm i humbjes, misticizmi që ndjell grija, shpeshherë të bëjnë të mendosh, se ai ka ndërtuar mbi përrallë.

Fjalët kyçe: *Martin Camaj, krijimtari, hulumtim, ndërtim, folklor, figura.*

Objekti i punimit

Ky punim synon të sjellë një këndvështrim të plotë mbi elementët intertekstualë në veprën e Camajt. Qëllimet kryesore mbi të cilët punimi kërkon të pasurojë studimet mbi Camajn janë:

- Së pari: ka për qëllim të identifikojë mitet, legjendat, strukturat përrallore, gojëdhënat, të drejtën zakonore, elementët etnografikë, referencat antropologjike, shprehjet frazeologjike, ndikimet nga letërsia popullore dhe e shkruar, shqiptare dhe e huaj. Përbërësit intertekstualë nuk kanë si synim klasifikimin në vetvete, por identifikimin si paratekst.
- Së dyti: këta elementë të rimarrë në vepër si ndërtekt, kanë një funksion të caktuar, në secilën poezi, prozë poetike, novelë, roman. Camaj ka ndërthurur në një funksion të ri, për këtë, ne e kemi vëzhguar me detaje se si transformohet elementi intertekstual dhe çfarë rëndësie merr. Shndërrimi i paratekstit dhe funksioni në vepër është një objektiv kyç.
- Së treti: punimi synon të analizojë ndërthurjen, shkrirjen, transformimin dhe rimarrjen e shtresës së identifikuar, në diskursin origjinal të Camajt. Shndërrimi i elementeve intertekstualë në figurë, personazh, mendësi, kompozicion, mesazh, këto përbëjnë thelbin origjinal të veprës së Camajt. Objektivi kryesor mbetet origjinaliteti i stilit të shkrimtarit, sepse ai i qëndron besnik simbolikisht traditës, për të përçuar mesazhe ekzistenciale.

Metoda e ndjekur përgjatë punimit së pari, ka të bëjë me identifikimin e paratekstit dhe intertekstit. Klasifikimi nuk ka për qëllim shterimin e lëndës intertekstuale por është element ndërlidhës i punës për analizën e të dy llojeve letrare. Metodika e ndjekur gjatë punës është drejtuar nga brendia e analizës së vetë tekstit të hulumtuar;

Analizat e detajuara, për të arritur në sintetizime të plota dhe të argumentuara, kanë qenë hapa përmbyllës gjatë punimit tonë.

1. HYRJE

Martin Camaj i takon radhës së shkrimtarëve tanë më të spikatur origjinal. Ai krijoi diku mes tradicionales dhe modernes. Temat dhe subjektet e tij letrare ndoshta janë “jashtë rrjedhave” ideologjike të kohës, jashtë pragmatizmit që diktonte ideologjia e përcaktuar, ngase ai ishte emigrant i përjetshëm, fizikisht por jo edhe shpirtërisht. Vepra e tij letrare, estetika e tij serioze krijuese u sendërtua në frymën e projekteve ekzistenciale, sociale, tematike në përkim me timbrin dhe kuptimin që ka në letrat tona sintagma e përhershme – mall e brengë. Ai, pra, sado që fizikisht ishte i veçuar, larg nesh, nuk ishte i ndarë prej synimeve tona të përgjithshme poetike e as prej traditës shqiptare, por përkundrazi, gjithmonë deshi dhe insistoi që krijimet, fjalën e tij letrare në prozë dhe në poezi, ta ekuilibronte me atë shqiptare në përgjithësi por edhe me atë moderne evropiane.¹ Siç shprehet edhe Koliqi, vepra e Camajt karakterizohet nga një leksik dhe frazeologji e zhdërvjellët – me një siguri vizatimi tiparësh të ndryshme – me një gjallëri dialogësh që zbulojnë të fshehtat e shpirtit të personazheve të tyre – me një stil shumëgjyresh, ku hijet e dritat ndërthuren me një mjeshtëri të natyrshme. Mbi këto pohime e vlerësime është ngritur edhe qëllimi kryesor i këtij punimi, i cili synon vënien në pah të elementeve social e kulturorë, që brenda teksteve të Camajt të përkthehen në gjuhë. Teksti si formë ligjërimi e komunikimi përmban e përçon të gjithë elementët e kulturës ku ai gjenerohet e ndërvepron. Duke e trajtuar tekstin si të tillë, në analizën e tij, nuk ndalemi vetëm në përcaktimin dhe inventarizimin e mjeteve shprehëse e figurative, por marrim në konsideratë edhe kushtëzimet kontekstuale kulturore e intelektuale në përzgjedhjen dhe përpunimin e mjeteve gjuhësore, duke synuar drejt një translinguistike.²

Në analizën e tekstit letrar elementet jashtëgjuhësore janë po aq të rëndësishme sa ato gjuhësore. Kjo sepse leximi i një teksti është një marrëdhënie, një ndërveprim në mes një folësi, në këtë rast shkrimtari dhe një lexuesi, të cilët jo domosdoshmërisht ndajnë të njëjtat dije gjuhësore, sociale e kulturore. Për pasojë, rrokja e kuptimit tërësor të tekstit mund të përballët me pengesa të cilat i kalojnë kufinj të gjuhës dhe nevojitet që për të

¹ A. N, Berisha, *Vepra letare e Martin Camajt*, “Princi”, Tiranë 2010, f. 158.

² T. Plangarica, *Mbi lidhjet e gjuhësisë me letërsinë në mësimdhënien e gjuhës shqipe dhe letërsisë*, Tiranë 2009, f. 7.

realizuar synimin e tij lexuesi të shkojë drejt tekstit i pajisur me dijet e nevojshme gjuhësore dhe jashtëgjuhësore.

1.1. Krijimtaria e Camajt

Lexuesi i veprës së Camajt nuk e ka shmangur thënien nisur prej të dhënave tekstore se ajo është e lidhur me truallin e të parëve³ në shumë drejtime: së pari përzgjedhja e kodit gjuhësor, e mbushur me njësi frazeologjike, tinguj të zgjatur të të folurit malësor; së dyti, përshkrime të gjalla të vendeve, ritualeve, mënyrës së jetesës, që e bëjnë njeriun të jetë i lidhur me tokën si me vetveten. Së treti: kode tokësore që udhëheqin personazhet, krijojnë konfliktet, japin zgjidhje. Mitet dhe legjendat janë pjesë e poezisë dhe dalin në prozë si pjesë e jetës së personazheve, përshkruhet dhe rrëfëhet për to, si mendësi, parandjenjë dhe fatalitet, ato janë pjesë integrale e veprës në kuptim dhe figurshmëri. “I lindur në Telum-Temal të Dukagjinit, ku lirika dhe epika gojore bënë jetë intensive dhe dalloheshin me një sistem të ngritur të shprehjes artistike dhe, pastaj, i shkolluar në Shkodër, qendër e madhe kulturore dhe letrare, Camaj do të gjejë mbështetje të madhe në këtë traditë.”⁴ A. Berisha thekson përkimet me paraardhësit si: Mjeda, Shiroka, Xanoni, De Martino, Fishta, të cilat nuk janë vetëm tematike por edhe të frymës e të tipareve të vargut, sistemit gjuhësor shprehës. Mirëpo, kjo nuk nënkupton imitim të traditës ose të ndonjë poeti të caktuar. Këtë Berisha e shpjegon me faktin se Camaj ishte njohës i shkëlqyer i poezisë së traditës dhe ishte i vetëdijshëm se çka mund të shfrytëzohej nga ajo dhe çka duhej shtuar e krijuar për të dëshmuar mëvetësinë e shprehjes poetike e kuptimore.⁵ Camaj u kthehet “gojadhanave sepse shprehte shumësinë e zërave të gjallimit të shqiptarit nëpër kohë. Ngjarjet që rrëfëhen janë në esencë shqiptim i konkretësisë ndërthurur e njësuar me përmasën legjendare, gojédhanore e mitike.”⁶ Më herët Koliqi, në parathënien e romanit *Djella*, vinte në pah se Dukagjini ka gjetur mjetin shprehës në

³ M. Camaj, *Tradita dhe bashkëkohësia*, Shkodër 1994. Në simpoziumin kushtuar Camajt, *Tradita dhe bashkëkohësia*, 1993, në shumë prej kumtesave vihet re raporti i veprës së Camajt me trashëgiminë letrare gojore, mite, legjenda, etno-folklor, etj.

⁴ A. Berisha, *Vepra letrare e Martin Camajt*, “Princi”, Tiranë 2010, f. 23.

⁵ Po aty, f. 24.

⁶ Po aty, f. 32.

artin e Camajt.⁷ Koliqi në krahasim që bën mes Camajt dhe At Benardin Palajt, thekson se si lënda e trashëguar e letërsisë gojore dhe të shkruar është shndërruar tek Camaj: “Tjetër tingull ka si poezia ashtu proza e Camajt. Pamjet e ndryshme të jetës së vendit të vizatueme me drita e me hije dridhëse. Atij, padashtas, i shkon syni ke brumi njerzuer.

N’ato vigaj të rruzem, ai kërkon njerin. Lufta që malsori ndërmerr për me dalë nga gurzimi i një gjendjeje shoqnore kurrkund në pajtim me kohën e sotshme, ia thekë shpirtin. Ai s’don qi burri i malsis të shikohet si specimen i një race të lashtë, objekt kureshti për t’u vendue në një muze. Nën leskrat xhixhilluese të një epiciteti anakronistik, syni vëzhgues i tij kundron me zemër të plasun rrudhat e shkaktueme nga uja, nga mundi i keq i shpërblyem prej natyrës e njerëzve e fatit, nga ndryshku i disa zakoneve damprurese, nga ngushtësia e vendit.”⁸ Koliqi në parathënien e botimit të parë të Djellës, vë theksin tek origjinaliteti i krijimit të Camajt: “Edhe asht për t’u mrekullue s’pari dhe mandej për t’u gzue, tue pasun para sysh pasunimin motivesh e trajtash të letërsis sonë, për mënyrën se si ky pinjuell malesh, sigurisht i pari i sojit të tij qi xen me shkruie e me këndue, din të harmonizojë në shkrime primitivitetin ruejtë në plotsin ma të plleshme me një zotnim të mjeteve ma të rafinueme t’artit letrar modern”.⁹ Në analizën e romanit Djella, Koliqi veçon mënyrën sesi Camaj e paraqet malësin, konfliktin mes traditës dhe të resë, jo si kundërshti të shkrimtarit kundrejt pasurisë folklorike po si burim urtie i gojëdhënave dhe paraqitje e botës psikologjike, duke i hequr tisin retorik. Koliqi e vlerëson pikëpamjen e Camajt, sipas tij pranimin e të shkuarës dhe traditës prej personazheve si identitet: “Tradita e shpëton burrin e malsis nga zvetënimi. E kombi, ndër qytete të mkamuna kah qytetnija, përtrihet e fuqisohet nëpër mjet të gjakut dhe të frymës së shndoshtë morale të bijve të maleve.”¹⁰ Koliqi e parathotë në mbyllje të analizës së tij se shmangia e konvencioneve të shtirura, do t’i bëjë vend romanit në letërsinë shqipe, mendimet e Koliqit, përmbliidhen në idenë e rëndësishme se Camaj është

⁷ E. Koliqi, *Arti i Martin Camajt*, parathënie e botimit të parë, Romë 1958, në: Camaj, M. Djella, “Onufri”, Tiranë 2012, f. 5.

⁸ E. Koliqi, *Arti i Martin Camajt*, parathënie e botimit të parë, Romë 1958, në: Camaj, M. Djella, “Onufri”, Tiranë 2012, f. 6.

⁹ Po aty, f. 7.

¹⁰ Po aty, f. 12.

i vërtetë në dhënien e karakterit njerëzor, këtë ai e ka pasqyruar më së miri në prozë dhe poezi. Letërsia e Camaj, shkruar e botuar në mërgim, kritikët e parë dhe fatmirësisht ndër më të rëndësishmit pati përkrahës dhe vlerësues seriozë të artit të tij. Pas Koliqit, Arshi Pipa, pohon se që me vëllimin e parë me poezi “Camaj angazhohet me një temë atdheun e vet, i cili do të jetë fokusi i gjithë prodhimit të tij letrar.”¹¹, megjithatë atdheu i Camajt sipas Pipës paraqitet në shumë prej “legjendave” janë parodi erotike prej përrallave popullore”¹², me aspektet negative të etnosit si hakmarrja. Pipa bën një përshkrim antropologjik të vendlindjes së Camajt, të shkollimit të tij, për të dalluar mendësinë me të cilin është mbrujtur shkrimtari nga krijimi letrar me referent vendlindjen dhe këndvështrimin për të. Sipas Y. Çirakut, Camaj e njëjtte mirë mitologjinë dhe folklorin shqiptar, ashtu siç ishte në kontakt edhe me kulturat evropiane, të vjetra dhe të reja, këto kanë ndikuar tek ai: “Kjo shtysë e thellë dhe e paramenduar, ka ndikuar te mbivendosja në poezinë e tij të detajeve, figurave e imazheve, të epokave të ndryshme dhe zhvendosjet poetike të pamjeve të sotme urbane me ato të hershme patriarkale, e deri mitologjike.”¹³

Ky model procedimi poetik është i komplikuar në receptim, Çiraku thekson se si duhet njohur ky kod specifik për të lexuar e mirëpritur Camajn: “Në koherencë me këtë kod, është i pranishëm i ashtuquajtur i arkaizëm estetik, d.m.th. vjetërimi i kohës, pra, shtimi i distancës së poetit me ngjarjen e rrëfyer. Kjo ka lidhje të ndërsjellë edhe me parimin etik të poetit, i cili nuk preferon artin e angazhimeve të drejtpërdrejta, pra manifeston një lloj mospërzjerje e mosimplikim të unit poetik me atë çka rrëfen: ashtu si ndodh në legjenda e përralla, kur koha e ngjarjes së rrëfyer është tepër e largët (me sekuencën e njohur narrative na ishte njëherë...) dhe pozita e narratorit anonim është pothuaj neutrale, ai vetëm rrëfen dhe u mbetet dëgjuesve të bëhen pjesëmarrës në interpretim.”

¹¹ A. Pipa, *Poezia dhe poetika e Martin Camajt*, në: Camaj, M.Njeriu më vete e me tjerë, Onufri, Tiranë 2012, f. 14.

¹² Po aty, f. 18.

¹³ Y. Çiraku, *Martin Camaj si përcjellës dhe krijues i një tradite*, në: Shqyrtime kritike nga Historia e Letërsisë Shqipe, “Albas” Tiranë 2011, f. 120.

2. PRANIA E INTERTEKSTUALITETIT

Citimi shfaqet me të drejtë si forma emblematike e intertekstualitetit: ai bën të dukshme përfshirjen e një teksti në një tekst tjetër. Kodet shtypshkrimore e vënë në jetë këtë heterogjenitet.¹⁴

Ndonëse i hapur, citimi nuk është më pak i ndërlikuar. Ai i kapërcen funksionet tradicionale që i njihen, autoritetin apo zbukurimin: i përfshirë në një roman, ai mund të jetë i përfshirë në tematikën e këtij romani si dhe në shkrimin e tij.¹⁵

Nga citimet e hapura të cilat dallohen edhe grafikisht, gjejmë shumë pak, ato vijnë si shprehje më tepër. Tek *Pishtarët e natës*, Camaj i identifikon Nikën si: “*arnyell i vetmuem mes ashtës, pa arnej tjerë pranë*”¹⁶ Kjo frazë paraqitet grafikisht si citim, megjithëse është shprehje e të folurës së malësorëve, ajo nuk përdoret përditë, pasi ligjërimi i Kolës është i zgjedhur përgjithësisht i figurshëm, i përdorur në kuvende ku fjalët peshojnë e nuk janë asnjëherë të rëndomta. Frazja tregon natyrën e Nikës, forcën për të mbijetuar më vete dhe në të njëjtën kohë, shpreh vetminë që e rrethon për vite.

Duhani i Nikës tek *Pishtarët e natës* është pjesë e ritualit mikpritës. Simbolika e ritualit mikpritës bëhet sipas traditës së trashëguar prej tij. Ajo që i bën personazhet e tjerë të diskutojnë rreth idesë nëse Nika ka ruajtur mikpritjen sipas traditës, apo ka ndryshuar duke qëndruar për vite vetëm. Gjithë situatat paragjykuese në lidhje me Nikën, krijojnë habi pasi nga njëra anë nuk njihen nipat, mbesat, gjakun e tij dhe nga ana tjetër mikpritja e tij nuk ka humbur asgjë nga madhështia primitive, nga besa, nderi, bujaria. Në këtë mikpritje paksa paradoksale nuk ka asgjë me Nikën si natyrë, por me respektin që ka për miqtë, që për Nikën bëhen urë lidhëse me botën.

Personazhi episodik i të ëmës së Bardhit në romanin *Djella* është i ngjashëm me Lenën tek *Pishtarët e natës*. Të dyja mishërojnë cilësitë e gruas tradicionale: të përlura e të përkushtuara kundrejt bashkëshortit. Kanë nderim për të parin e familjes gati deri në adhurim, duke i veshur cilësi edhe pse figurativisht të mbinatyrshme.

¹⁴ N. Piegay-Gros, *Poetika e intertekstualitetit*, “Parnas”, Prishtinë 2011, f. 15.

¹⁵ Po aty, f. 64

¹⁶ M. Camaj, *Novela*, “Onufri”, Tiranë 2012, f. 46.

Tek novela Pishtarët e natës, Nika mishëron dyzimin e malësorit që beson në qenie mitologjike e njëkohësisht ka besim në ndjekjen e riteve të besimit në një zot të vetëm. Kjo përzierje besimesh pagane dhe monoteiste bën që dhe vetë ai, të jetë i dyzuar në qëndrimet e tij. Nga njëra anë ai beson në ekzistencën e orëve dhe të zanave, nuk u përmend as emrin, përdor eufemizma për to, nga ana tjetër e sfidon besimin se Fundina është e pushtuar nga orë e zana, atje hap e zgjeron toka, e kthen në vend të banueshëm nga njerëzit, megjithëse vetëm ai mund të qëndrojë për një kohë të gjatë në një vend të tillë. Dimri gjithmonë e bën dyshues dhe bestytës, gjatë kësaj periudhe ai jeton me frikën e qenieve të mbinatyrshme. Nika e parandjen vdekjen. Ai e ka sfiduar edhe frikën për të gjuajtur, pasi sipas besimit popullor në kafshë gjendet dhe shpirti i qenieve të mbinatyrshme. Nika ka përfituar prej gjuetisë të mirat materiale dhe ka arritur të shtojë pasurinë, e ka arritur të blejë toka të reja, t'i sigurojë familjes të ardhmen. Por e gjithë kjo e di që do t'i kushtojë. Gjuetia është e ndaluar, prandaj dhe vdekja i vjen prej saj.

Camaj risjell edhe figurën e katallanit, tek novela Gjon Gazulli dhe Pishtarët e natës, gjendet si krahasim, për personazhet kryesore. Ndërsa tek romani Rrathë dhe Karpa merr kuptim më të gjerë. Tek Rrathë, Ylli paraqitet me prejardhje prej fisi katallajsh. Në frazeologjinë popullore, ky krahasim është i dëndur kur bëhet fjalë për kuptimin përkeqësues të sjelljeve të dikujt. Ylli krahasohet me Katallanin për karakterin që shfaq, lëvizjeve të duarve dhe synimeve të tij. Ky vision përforcohet nga rrëfimi autorial për fisin i tij, një fis prej njëzet vetash, trupmëdhenj, po me zemër të vogël. Origjina e tyre nuk është vendase e prandaj nuk pranohen prej tyre. Kjo lloj figure e ngjashme me katallanin është metamorfoza që ka krijuar njeriu kundër njeriut në rrethanat e një pushteti të ri, që ngjan më shumë i përbindshëm se njerëzor.

Me Nikën, Camaj risjell në letërsi pamjen kreshnikut arkaik, në dy mënyra: e para është një përshkrim i drejtpërdrejtë i rrëfimtari dhe e dyta krijohet përmes përshkrimit të personazheve të tjerë, thashethemeve të hiperbolizuara. Në përshkrimin dhe rrëfimin e drejtpërdrejtë kemi përshkrimin epik: “dy metra i gjatë”, “Hija e Nikës në endje përzihej me hijet e lisave e të currave”, “me ata sy shigjetë që në dritën e qiriut e të zjarmit shkëlqenin si krena gjarprijsh mes vetullave të trasha ua prente të gjithëve fjalën në gojë.”

Nika mallkon me shprehje të hiperbolizuara karakteristike të eposit, shpërthime të vrullshme që mbartin zemërimin e njeriut e oshëtimën mesjetare. Gjithë zemërimi i Nikës përcillet përmes zërit që ngjall frikë tek njerëzit dhe natyra: “Nika nuk shante, por nemte e trunte tue thirrë gjamë e vetëtimë që t’i gjuente me kokërr të vet, me rrëfenë, e të çfaroste çdo send të gjallë që i shkelte dhenë.”¹⁷

*“Fjalët e tij burrnore tmerronin shtazë e njerëz dhe depërtonin jehonë në jehonë prej shkambit në shkamb dhe shuheshin tue ra në pushim larg gjije e humnere, përkueshëm, si petk i mbajtur prej të njëjtit trup, sepse andej pari shungullonin vetëm zani i Nikës e bubullima e motit të keq, ndërrueshëm simbas rastit e kohës.”*¹⁸

Mënyra e dytë e portretizimit të Nikës është përmes hiperbolizimit të thashethemeve për të. Në novelë ato krijohen natyrshëm, pasi Nika ka kohë që ka krijuar distancën kohore dhe hapësinore me të tjerët, të njohur dhe të panjohur, aq sa gruaja dhe fëmijët fillojnë të zgjojnë përfytyrimin e njeriut të jashtëzakonshëm, të kreshnikut që ka lidhje me Orë e Zana. “Ata kallzuen edhe për mrekullinë e pishtarëve të natës dhe për Nikën, burrë gjigant, i veshun në lëkura e sukuj zhgunash, me një za që mbushte me shungullimë lugima e bjeshkë; gjithçka kallëzohej bindshëm se ai paska punë edhe me Orë e Zana.”¹⁹

Lena u krijon të bijve përfytyrimin e njeriut që duhej respektuar e pasur drojë prej tij: “Fliste ashtu sikur Nika të ishte zoti i ernave...”, si Lena, të bijtë dhe të afërmit fillojnë të kenë hijen e dyshimit, në këtë mënyrë thuren legjendat rreth Nikës kreshnik. Camaj këtë besim të personazheve të tij e paraqet në disa paragrafë shpjegues se si krijohet legjenda rreth vetmitarit: “...kështu e kështu dhe mandej, si punë fare të kryeme, e len me ra si prej qiellit, copë akulli në vend të kokrrës së breshnit, as me qenë thashethana një kangë kreshnike treqind vargjesh.”²⁰

Në portretizimin e Nikës bën pjesë dhe vetë besimi i tij në qeniet e mbinatyrshme, herë është frikë bestytëse e tij si gjahtar, herë është dëshirë e njeriut që gjatë dimrit është në ankthin e vetmisë, e herë është dëshirë për të qenë me një grua, qoftë kjo dhe zanë.

¹⁷ M. Camaj, *Novela*, “Onufri”, Tiranë 2012, f. 23.

¹⁸ Po aty, f. 24.

¹⁹ Po aty, f. 62.

²⁰ Po aty, f. 29.

Tek Pishtarët e natës nuk bëhet dallimi mes Orëve dhe Zanave, Camaj përdor eufemizma, duke treguar se besimi i personazheve të tij është i përzier mes paganës dhe besimit në një zot të vetëm. Nika i frikohet përmendjes direkte të emrit të Zanës dhe Orës, prandaj e zëvendëson me: Shtojzovallet, Të lumet, Të lumet e natës, Shpirtën të malit, Shpirtën të fuqishëm, Shpirtën të pavdekshëm. Ai luhetet mes frikës dhe guximit për të jetuar e punuar vetëm, ky dyzim e ka bërë akoma më të afërt me të mbinatyrshmen.

Nika e parandjen vdekjen, atij i përsëritet e njëjta ëndërr: vrasja dhe ringjallja e një ujku. Frika e tij lidhet me besimin se kafshët janë bartëse të shpirtit të qenieve të mbinatyrshme. Gjithë pasurinë e tij ai e ka siguruar përmes gjuetisë, të cilën ia pohon vetëm të shoqes. Vdekja e Nikës shihet si përmbushje e ëndrrës paralajmëruese. Në veprat epike ëndrra të tilla janë të pranishme gjithmonë dhe parathënë fatin e personazheve. Jeta dhe vdekja e Nikës janë rindërtimi dhe portretizimi arkaik i malësorit që jeton mes natyrës më shumë se mes njerëzve, që gjithçka e mëson rreth vatrës së zjarrit, nga miqtë që u bie rruga, siguron jetesën me tokën dhe egërsirat e malit, që ëndërron për fuqinë e mbinatyrshme, parandjen të ardhmen, ruan e përçon traditën, kur vdes vishet me rrobat më të mirat, vajtohet me gjamë e fjalët më të zgjedhura, dita e vdekjes bëhet ngjarja më e rëndësishme se e gjithë historia e jetës së tij.

Tek Pishtarët e natës, njësitë frazeologjike përdoren nga Nika, Lena dhe të bijtë. E folura duket se merr shprehje të ngjashme në një familje, ata i përngjajnë njëri-tjetrit nga përdorimi i të njëjtave shprehje, megjithëse kjo tregon se i foluri është më i drejtpërdrejtë e më rrallë lë hapësirë për nënkuptime. Njësitë frazeologjike përdoren nga Lena, kur kërkon ta zbusë bisedën dhe të marrë vesh atë që ajo do të dijë. Edhe Nika përdor të njëjtën mënyrë të përdorimit të njësive frazeologjike:

1. Lena, e cila shtërngoi dhambët për të bartë trimnisht rrahjen e burrit, pa qitë za goje dhe pa i ra syve qepallë.
2. Të gjithë i niste me një grusht miza në shpinë e fjalë të randa.
3. Si lang verri janë të idhëta, or burrë: fjalët e botës.
4. Tue e fshehë qotimin si mollën e vetme në turrën e dushkut.
5. Ndër katunde, siç thue ti, kam mësue me i ardhë çdokujt te udha.

6. Kola e burrat e arrasve, dikush thumbit, dikush patkoit, s'dinin me i dhanë fund kuvendit.
7. Ndonëse nuk di me folë, ashtu si kusi e shpueme që nuk e mban pikën e ujit!
8. E mandej duhet ba ashtu si ban ujku që e mban për vete e s'i jep shej kuj se ku ha mish.
9. Dreqi se merrte vesh punën e tyne!
10. Kush flen me qen, çohet me pleshta.

2.1. Marrëdhënia e personazheve me tokën, fat dhe frikë

Në nivele më konkrete është marrëdhënia e personazheve në novelën *Pishtarët e natës*, ku toka shihet si burim jetese, e zgjerimi i saj do të thotë më shumë të ardhura, sfida me të është sfidë për mbijetesë. Personazhet janë të varur nga toka, nga ajo që u jep ajo, e kanë krijuar legjenda, kulte e mite për raportin me të. Shumë e kanë frikë e shumë e sfidojnë si Nika, po në fund frika arkaike fiton. Fatin e përcakton natyra e kundrejt saj duhet të sillen me nderim, si Lena, fëmijët, Loshi, Jera etj, të gjithë hamendësojnë për atë që mund t'u ndodhë kur i kundërvihen asaj.

Në prozën e Camajt, megjithëse voluminoze, si novelat edhe romanet, personazhet që ndeshim janë pak. Një nga arsytet është secili prej tyre edhe kur ndërtohet çift në moment të caktuar është i rrethuar nga vetmia, e cila buron së brendshmi shpesh e pasohet edhe nga rrethanat jetësore. Nëse i marrim me radhë personazhet do të vëmë re se në një çast të jetës së tyre janë rrethuar nga vetmia, ky fill e përshkron veprën e tij si metonimi. Personazhet përbëjnë një masë vetmitarësh.

Nika tek *Pishtarët e natës* e ka zgjedhur të jetuarit vetëm prej egos për të marrë hapësira e për ta bërë tokën të vetën, për t'u lënë pasardhësve më shumë se ai kishte marrë prej të parëve të tij. Kjo mënyrë jetese e bën të largët me të njohurit e të çuditshëm, për të panjohurit. Vdekja e tij, i vetëm pa askënd pranë, ashtu siç kishte jetuar shpreh tragjikën e njeriut, që kërkon të arrijë shumë me vetminë e tij, e në fund mbetet vetëm një kujtim i bukur vetëm i Lenës dhe i askujt tjetër. Jera vendos të jetojë vetëm në një moshë

kur vajzat e tjera nisin të gëzojnë rininë e tyre, vetmia për të është shenjë zie. Është një mënyrë konservimi e dashurisë për Dakun.

Gjon Gazulli përzgjedh të tërhiqet në vetmi, për të gjetur kuptimin e përsiatjeve të tij. Për të është frymëzim dhe koha që kalon humbet pa kuptuar sa ka kaluar. Vetmia është kërkim dhe kuriozitet i pafund, i kthyer në krijimtari.

Tek Pishtarët e natës marrëdhënia Lena-Nikë, është qasje dramatike e mënyrës zakonore të martesës e jetesës, ku çifti është pjesë e jetës familjare, më shumë se një raport jetësor i ndërtuar mbi dashurinë. Lena rinis të gjallërojë lidhjen me Nikën, pas një kohe të gjatë të shkëputur mes tyre, ata përpiqen të rifitojnë vitet e humbura e të vetmuara larg njëri-tjetrit. Fillimisht për Lenën është një mënyrë për të sfiduar të dashurën fiktive a reale të Nikës, e për vetë Nikën dashuria është e barabartë me pasardhësit. Koha e përjetimit të dashurisë mes Nikës dhe Lenës, duket një kohë e vonuar, ku edhe fëmijët i shohin më shumë si dashnorë të njëri-tjetrit, se si bashkëshortë. Duket e pakuptimtë në sytë e tyre rigjallërimi fizik dhe shpirtëror i dashurisë, për ta është e pakuptimtë shprehja hapur, prandaj Camaj vë në fjalët e djemve shprehje ironike: “Burr i malësisë ndër Gurra shtiret si me i pasë lanë diçka mangut kësaj jete, kinse i flijuem me vjetë për të mbarën e familjes.”²¹

Lenën pas vdekjes së Nikës do e mbajë gjallë kujtimi i dashurisë për Nikën, jo si martesë njëzetvjeçare, por stina e fundit që kalon me të. Martesa e tyre përmbledhet në përjetimin e një stine.

Në novelën Pishtarët e natës, qyteti thuhet nuk ekziston, ai është larg, gati si një botë tjetër krejt e panjohur si për ata që jetojnë bjeshkë si për ata që jetojnë në verri. Qyteti është Shkodra si një vend konkret, e cila lidhet me tregtinë dhe asgjë më shumë. Qyteti nuk ekziston si njësi administrative, politike, ajo që dinë për të lidhet me ngjarje dhe njerëz të cilat nuk kanë aspak ndikim tek malësori që e ka ndërtuar jetën me natyrën. Izolimi ose vetizolimi nuk janë diçka e kërkuar, por një fat të cilin personazhet nuk e shohin si pjesë të domosdoshme të jetës së tyre. Lidhja me qytetin, me të huajt, prej Nikës bëhet si shkëmbim bisedash me të panjohur që u bie udha andej, ata ndikojnë në

²¹ M. Camaj, *Novela*, “Onufri”, Tiranë 2012, f. 59.

mirëqenien e Nikës, ai vjel prej tyre aq sa i duhet dhe u jep nga mikpritja, bujaria, besa, virtyte të ruajtura të bëra doke.

Nika nuk e njeh as e ka parë kurrë qytetin, për të ai mbetet një mit, i panjohur, por deri në fund të jetës nuk ka as kuriozitetin më të vogël për ta njohur. Ai është malësori që nuk e çon dot jetën asnjë ditë larg tokës e gjësë së tij. Megjithatë kur të huajve, qytetasve nuk u bie rruga nga Nika, ose kalon një kohë e gjatë pa takuar kënd, ai ndjehet i vetmuar, ata i sjellin të rejtat, të panjohurat, ngjarje që kanë lidhje me shoqërinë, shtetin, po të gjitha për Nikën, janë në një qytet të largët, e deri tek ai arrijnë veçse si histori. Camaj nuk tregon vetëm se ky malësor nuk ka lidhje me shoqërinë dhe nuk ndërhyt të ndryshojë fatin e shtetit por është krejtësisht indiferent, egoist dhe individ që përveç familjes së tij, më tej nuk përbën asnjë rëndësi në ndryshimin e asgjëje. Në këtë formë demitizohet malësori trupmadh, i fuqishëm, i izoluar e si ai janë të shumtë, të shpërndarë në fshatra të largëta, që e kalojnë jetën në një vetmi shpesh primitive. Camaj ka trajtuar në këtë mënyrë një temë që letërsia e mëparshme por edhe ajo e realizmit socialist e kishte tabu, indiferentizmin dhe egoizmin e njeriut, që qëndron larg shoqërisë, jo thjesht pse ka zgjedhur por në këtë mënyrë është rritur, edukuar e është i destinuar ta mbyllë jetën, pa e njohur qytetin, bërthamën e një shteti e qyteti pa e njohur atë.

Jo pa ironi Camaj fjalën autonomi e shkruan sipas mënyrës se si e kupton personazhi i tij: “Të mbramët që i ranë Nikës te dera, në ndamjen e vjeshtës e të dimnit, qenë dy shqiptarë, nëpunës të Portës që i rrëfyan këtij se ishin kryengritës e luftonin për atonomi. Ndonëse kjo fjalë ia lurtoi fort veshin malësorit, megjithatë s’mundi t’ia rrokë vështrimin. Atonomi - ia shkoqitën ata skajimin Nikës - don me thanë, tue shkue fjalës thellë në rrajë, me qeverisë na veten, tue thanë vetëm për sy e faqe se nuk e kemi këputë fare me turk.”²² Nika e kupton se kjo nuk i përket atij kur u drejtohet kryengritësve se “Thelbi qenka se turke na paska marrë andrrën e keqe, e mbasi nuk qenka ma i rrezikshëm, mundta lamë do kohë edhe si dordolec mbi lakna! Shikoni, or burra, ashtu as grues s’i thuhet, jo ma atij që ju ka sundue pesëqind vjet!”²³

²² M. Camaj, *Novela*, “Onufri”, Tiranë 2012, f. 89.

²³ Po aty, f. 89.

Kjo bisedë nuk përfundon aspak me mirëkuptim, të dy kryengritësit largohen të ofenduar prej kasolles së Nikës, duke mos e kuptuar se ai nuk është kundër parimeve të tyre, por për të është krejt e përjashtuar mundësia se cilido shtet do të ndikojë në jetën e tij, qoftë turk apo shqiptar. Për Nikën flitet e sajohen histori të ndryshme, legjenda, ai është një mjegull për qytetasit që nuk e njohin, një njeri i të tjera kohëve. Mungesa e koherencës, komunikimit bën që ky njeri të mbetet siç është shprehur Shaban Sinani, një in-dividum: “Fataliteti ndjek individin, të pandashmin; fataliteti ndjek bashkësinë; fataliteti ndoshta ndjek dhe Shqipërinë.”²⁴

2.2. Universalizimi dhe simbolika e mitit të ujit

Sipas Camajt ky lajmëtar është poeti, “çdo poet që i ka këndue e ka për t’i këndue prap Drinit”.²⁵

Drini përveç se legjendë, burim frymëzues, kthehet në ligjërim poetik. Lumi është parë si “similitudë udhëtimi”, por ai në dy poezitë që do të analizojmë është përjetësim i kohës, është dëshmitar i ndryshimit të moshës njerëzore, duke qenë vetë i pandryshueshëm dhe i përjetshëm.

Në poezinë Grue e pjekun lëvizja e ujit të Drinit ka tre faza të cilat janë:

- a) lëvizja e qetë ritmike
- b) lëvizja që arrin kulmin në lartësinë e një rryme
- c) lëvizja e rrëmbyeshme e përnjëhershme e gjithë sasisë së ujit.

Këto faza përkojnë me tri fazat e moshës së njeriut në këtë poezi:

- a) fëmijëria
- b) rinia
- c) plakja

Këto tri faza përkojnë me tri strofat e poezisë, ku në çdo strofë kemi nga një lëvizje të lumit. Tri strofat duket sikur e ndajnë në tri kohë lëvizjen. Këto nuk janë çaste kohore,

²⁴ Sh. Sinani, *Parathënie në: Camaj Martin Novela*, “Onufri”, Tiranë 2012, f. 16.

²⁵ M. Camaj, *Pishtarët e natës*, “Parnas”, Prishtinë 1991, f. 12.

por periudha të jetës së gruas së rritur tashmë. Në lëvizjen e lumit ajo sheh kujtimet dhe jetën e saj, në mosha të ndryshme.

Lumi i ndan dhe bashkon malësorët e Alpeve me fusharakët e vërrinit, në novelën *Pishtarët e natës*. Uji i shndërruar në borë, frikë e ankth nga natyra, i metamorfizuar si vdekje në prag pranvere, me shkrirjen e borës, me ndryshimin e natyrës dhe njeriut.

PËRFUNDIM

Qëllimi parësor i këtij studimi ishte ravijëzimi i disa prej varianteve të stileve krijuese, që kanë mbizotëruar në poezinë shqipe të gjysmës së dytë të shekullit të XX. Mes heterogjentetit të stileve e modeleve të të shkruarit të poezisë shqipe bashkëkohore, ne u fokusuar tek autori, Martin Camaj, sepse ky përfaqëson një model të novelave të konsoliduar që ka udhëhequr rrugëtimin dhe prirjet e përgjithshme zhvillimore të novelës shqipe.

Gjatë hulumtimit tonë, u ndalëm tek elementet dominuese të strukturës së novelës dhe përmes analizave konkrete, gjë që mundësoi, në një farë mënyre, edhe evidentimin e skajeve kryesore të larmisë artshkruese të poezisë.

Skajet e estetikave krijuese përvijohen kryesisht në luftën e traditës me të renë, këtyre dy të kundërtave që kanë qenë dhe mbeten motori gjenerues i novelës shqipe. Kjo skajshmëri prirjesh përbëhet, nga njëra anë, prej shenjave të ligjërit të drejtpërdrejtë e bisedor, që i drejtohet një mase të gjerë lexuesish e që ndryshe njihet edhe si stil tradicional i të shkruarit dhe nga ana tjetër, përbëhet prej shenjave të ligjërit abstragues, eliptik, simbolik, ironik, sugjestiv dhe ezoterik e që konsiderohet si stil modern. Në mes kësaj dikotomie kemi edhe stile të ndërmjetme, herë me shprehje moderne dhe përmbajtje klasike dhe herë e anasjellta. Lënda poetike e përzgjedhur për trajtim na e ilustron më së miri këtë prani heterogjene.

Procesi i analizës së strukturës së novelës, i udhëhequr prej konceptit të dominantes në tekst, specifikoi veçoritë e individualitetit krijues të poetit dhe përvijoi prirjet kryesore krijuese të tij.

Camaj e shtrin komunikimi në pafundësi rrjetesh strukturore e ideore. Errësimi i shprehjes gjuhësore gjeneron shumëngjyrësi rrafshesh interpretuese dhe qasja subjektive përlligjet në çdo grimcë të tekstin poetik. Kjo formë e të komunikuarit mund të jetë rezultat i pavetëdëshëm i marrëdhënies reale inekzistente mes autorit e lexuesit,

marrëdhënie që butthohet edhe në planin estetik. Ngarendja drejt përsosmërisë së shprehjes poetike, fjalorit dhe strukturës poetike në përgjithësi, ia ka zbehur fuqinë pikëtakimeve konkrete me lexuesit, duke ndërtuar një marrëdhënie racionale e njëherësh paradoksale, sepse kuptimi i përfutur prej lexuesit vështirë të përputhet me atë të autorit.

Për shkak të gjuhës ezoterike dhe shprehjes tejet moderne, novela e saj është konsideruar si hermetike, larg interpretimit të drejtpërdrejtë e njëdimensional dhe për pasojë, larg lexuesit masiv. Çështja e hermetizmit dhe pikëtakimet e Camajt me të, janë ende në vazhden e diskutimeve ndër studiues, ku një pjesë studiuesish e etikojnë këtë poezi trajtë të mirëfilltë të hermetizmit, ndërsa një pjesë tjetër nuk shohin asnjë gjurmë të hermetizmit, veçse errësim të shprehjes poetike si përpjekje për të lartësuar nivelin estetik, gjë e cila nuk duhet barazvlerësuar domosdoshmërisht me hermetizmin.

Novela e Martin Camajt karakterizohet nga prania e kapërthimeve të dy përbërësve, realiteteve dhe tipareve që bashkëjetojnë së bashku, pavarësisht antagonizmit të tyre. Kjo dikotomi është e kudogjendshme, në shprehjen e kompozimin poetik dhe në planin e përmbajtjes. Në aspektin formal, nëse do t'i përimitonim disa nga tipologjitë e dikotomive ato do të shfaqeshin në sintetizimet e gjuhës me letërsinë, të lirikes me epiken, të vargut të rregullt me vargun e lirë, të ritmit me aritminë dhe me hibridizimin e zhanrit të prozës me poezinë.

Në themel të poezisë së Martin Camajt është edhe elementi i paradoksit, që përftohet në dy forma: paradoksi semantik (gjuhësor) dhe ai strukturor. Paradoksi semantik lidhet me funksionimin e figurave të veçanta poetike, ose të njësive minimale semantike, të cilat në vetvete shëmbëllojnë kombinime të habitshme, si p.sh. figura e Dranjes, që paraqitet si një qenie stramastike e breshkës me gjarprin dhe në çdo madrigal gjeneron shumësi domethëniesh. Ndërsa paradoksi strukturor ndryhet në ndërlidhjet dhe kombinimet mes sememave dhe tekstit si tërësi shenjash. Elementet e paradoksit në poezinë e Camajt janë të shtrira në disa nivele tekstuale, që nga ndërtimi i figurave të ndryshme poetike e deri te ndërtimi gjuhësor, i cili prodhon imazhe të ndryshme dhe polivalencë semantike. Poezia e

këtij autori lidh e afron brenda vargut dhe njërive më të mëdha koncepte të largëta e të papritura, që vështirë mund të qëndrojnë në raporte ndërlidhjesh, duke përfshirë në këtë fushë, sikur në tërë kuptimin, mundësinë e eksperimentit gjuhësor e të figurave. Figurat më të zakonshme që i janë nënshtruar logjikës së paradoksit janë: gjarpri, breshka, buelli, korbi, dielli, hija, guri, lisi etj., të cilat shënjojnë edhe konceptet kyçe të opusit të tij poetik.

Trajtësimet estetike të përbërësit kohë-hapësirë në poezinë e Martin Camajt shfaqen gjithnjë në pamje tredimensionale. Kjo pamje nuk nënkupton qartësinë e një imazhi konkret, por paraqet në mënyrë të vagullt një pamje surrealistike, në të cilën konfigurohet e shkuara, e sotmja dhe e ardhmja, jo thjesht në kuptimin kohor, por edhe me toposet hapësinore karakterizuese të secilit aspekt. Koncepti "kohë-hapësirë", ashtu siç brendësohet në gjithë letërsinë artistike, edhe në poezinë e Camajt paraqitet i pandashëm, sepse asnjëri element nuk mund të ekzistojë pa tjetrin.

Literatura

- A., Berisha, *Vepra letrare e Martin Camajt*, Princi, Tiranë, 2010.
- A.N, Berisha, *Vepra letare e Martin Camajt*, Princi, Tiranë, 2010.
- M. Camaj, *Novela*, Onufri, Tiranë, 2012.
- M. Camaj, *Pishtarët e natës*, Prishtinë, 1991.
- Y. Chevrel, *Letërsia e krahasuar*, Albin, Tiranë, 2002.
- Y. Çiraku, Martin Camaj si përcjellës dhe krijues i një tradite, në: *Shqyrtime kritike nga Historia e Letërsisë Shqipe*, Albas, Tiranë, 2011.
- Ardian, Klosi, *Takim me Martin Camajn* (në vend të parathënies), *Vepra Letrare 1*, Apollonia, Tiranë, 1996.
- E. Koliqi, *Arti i Martin Camajt*, parathënie e botimit të parë, Romë, 1958, në: *Djella*, Camaj, M. Onufri, Tiranë, 2012.
- Martin Camaj, *Tradita dhe bashkëkohësia*, Shkodër, 1994. Në simpoziumin kushtuar Camajt, *Tradita dhe bashkëkohësia*, 1993, në shumë prej kumtesave vihet re raporti i veprës së Camajt me trashëgiminë letrare gojore, mite, legjenda, etno-folklor, etj.
- Petrit Koçi, *Në poetikën e Martin Camajt*, botues "Dita", Tiranë, 1997.
- N. Piegay-Gros, *Poetika e intertekstualitetit*, Parnas, Prishtinë, 2011.
- A. Pipa, *Poezia dhe poetika e Martin Camajt*, në: Camaj, M. Njeriu më vete e me tjerë, Onufri, Tiranë, 2012.
- T. Plangarica, *Mbi lidhjet e gjuhësisë me letërsinë në mësimdhënien e gjuhës shqipe dhe letërsisë*, Tiranë, 2010.
- Sh. Sinani, Parathënie në: *Camaj, M. Novela*, Onufri, Tiranë, 2012.
- Shaban Sinani, *Camaj i paskajuar (Rreth tipologjisë së llojeve në veprën e Martin Camajt)*, Qendra e Studimeve Albanologjike & Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2011.
- Agim Vinca, *Struktura e zhvillimit të poezisë shqipe (1945-1980)*, Rilindja, Prishtinë, 1985.